



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VIII**

**Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti**

**Plani i punës për vitin 2021**

Maj, 2021  
Prishtinë

**Kryetar i Komisionit,**  
**Ferat SHALA**

## *Përmbajtja*

- Hyrje
- Anëtarët e Komisionit
- Fushëveprimi i Komisionit
- Rregullat për organizimin e brendshëm
- Organizimi i brendshëm i Komisionit
  - *Kryetari*
  - *Nënkryetarët*
  - *Raportuesit*
- Agjenda e Komisionit sipas muajve

## **Hyrje**

Në bazë të Rregullores së Kuvendit të Kosovës dhe praktikës së punës së Komisioneve Parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti (tutje: Komisioni) harton planin e aktiviteteve për secilin vit. Plani i punës së Komisionit mund të ndryshojë sipas nevojës dhe aktiviteteve të Komisionit.

Komisioni, gjatë vitit 2021, si aktivitete kryesore do t'i ketë shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjeve; nisma legislative; mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve; monitorimin e resorëve të Qeverisë që bien në fushëveprimin e Komisionit; mbikëqyrjen e agjencioneve të pavarura të fushëveprimit të Komisionit; mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të Komisionit/Kuvendit. Komisioni do të bashkëpunojë me të gjitha institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare, do të angazhojë ekspertë dhe do të bashkëpunojë ngushtë me organizatat joqeveritare vendore e ndërkombëtare nga fusha e ekonomisë, tregtisë, industrisë etj.

Në këtë plan pune, Komisioni paraqet të gjitha aktivitetet e tij për vitin 2021.

**Anëtarët e Komisionit dhe stafi mbështetës**

<b>Numri rendor:</b>	<b>Emri dhe mbiemri</b>	<b>Njësia mbështetëse e Komisionit:</b>
1. Kryetar	<b>Ferat SHALA</b> (G/P – PDK)	<b>Armend Ademaj,</b> Kordinator i Komisionit
2. Nënkyetare e parë	<b>Jeta STATOVCI</b> (G/P – LVV)	<b>Muhamet Morina,</b> Zyrtar i lartë i fushës
3. Nënkyetare e dytë	<b>Fidan Jilta</b> (G/P – Multietnik)	<b>Veton Raci,</b> Zyrtar i fushës
4. Anëtar	<b>Gramoz AGUSHOLLI</b> G/P – LVV)	
5. Anëtar	<b>Driton HYSENI</b> (G/P – LVV)	
6. Anëtare	<b>Mimoza KUSARI -LILA</b> (G/P – LVV)	
7. Anëtar	<b>Armend MUJA</b> (G/P – LVV)	
8. Anëtar	<b>Uran ISMAILI</b> (G/P – PDK)	
9. Anëtare	<b>Valentina BUNJAKU-REXHEPI</b> (G/P – LDK)	
10. Anëtar	<b>Ljubinko KARAXHIQ</b> (G/P – SL)	
11. Anëtar	<b>Pal LEKAJ</b> (G/P – AAK)	

## **Fushëveprimi i Komisionit**

Në bazë të nenit 69 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti është Komision FunkSIONAL.

Fushëveprimi i këtij Komisioni përfshin:

- Shqyrtimin e projektligjeve të fushëveprimit të tij;
- Konceptimin e strategjisë së përgjithshme për zhvillimin e veprimtarive ekonomike ndërmjet Kosovës dhe shteteve të tjera, duke i bërë rekomandime Kuvendit dhe ministrisë përkatëse etj.;
- Krijimin e infrastrukturës ligjore e të ambientit më të sigurt për investime, për marrëveshje tregtare, për koncesione në energjetikë, resurse minerale dhe që lidhen me zhvillimin e këtyre degëve ekonomike.
- Angazhimin për përcaktimin dhe përcjelljen e zbatimit të politikave të përgjithshme në fushën e ekonomisë, tregtisë, industrisë, energjetikës, teknologjisë informatike dhe fushave tjera në kuadër të përgjegjësive;
- Monitorimin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit – MSA, sipas përgjegjësive të ministrive dhe resorëve tjerë që i mbikëqyrë komisioni;
- Shqyrtimin e projektbuxhetit dhe rishikimin e buxhetit të ministrisë së resorit përkatës dhe të agjencive të pavarura dhe i rekomandon Komisionit për Buxhet, shqyrtimin dhe miratimin e tij në Kuvend, duke i përfshirë edhe amendamentet;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve të fushëveprimit të tij;
- Mbikëqyrjen e punës së agjencive të pavarura dhe rregullatorëve të themeluara nga Kuvendi, si dhe shqyrtimin e kandidatëve për borde;
- Shqyrtimin e performancës së ndërmarrjeve publike;
- Shqyrtimin e çështjeve të tjera të përcaktuara me Rregullore dhe të çështjeve, të cilat me vendim të veçantë të Kuvendit i barten këtij Komisioni.

Në ushtrimin e funksioneve, Komisioni bashkëpunon me ministrinë e resorit përkatës dhe me të gjitha ministrinë e tjera, nga të cilat mund të kërkojë të dhëna konkrete, i duke përfshirë këtu edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohet nga Komisioni.

## **Rregullat për organizimin e brendshëm**

- Komisioni ndërton punën e tij dhe funksionon në bazë të Rregullores së punës të Kuvendit;
- Dispozitat që rregullojnë kryesimin e Kuvendit janë bazë edhe për kryesimin e Komisionit;
- Komisioni ka kryetarin dhe dy nënkryetarë;
- Komisioni ka stafin koordinues/mbështetës;
- Komisioni, me dy të tretat e votave, mund të krijojë një ose dy nënkomisione;
- Komisioni, për punë apo fusha të caktuara, mund të krijojë grupe të punës;
- Nënkomisionet dhe grupet e punës i raportojnë Komisionit;

- Komisioni mund t'i caktojë anëtarët e tij si raportues për një çështje ose fushë të caktuar;
- Mbledhjet e Komisionit i thirr dhe i kryeson kryetari, ose në mungesë të tij, nënkryetari;
- Mbledhjen e Komisionit mund ta thërrasin edhe një e treta e anëtarëve të Komisionit;
- Komisioni vendos me konsensus ose me shumicë të votave;
- Deputeti që nuk pajtohet me qëndrimin e shumicës, ka të drejtë t'i bashkëngjisë qëndrimet e veta raportit të Komisionit;
- Mbledhjet e Komisionit janë të hapura, përveç kur Komisioni vendos ndryshe;
- Në mbledhjen e Komisionit mund të ftohen dhe të marrin pjesë përfaqësues të Qeverisë, përkatësisht ministrisë përkatëse, përfaqësues të institucioneve dhe asociacioneve të interesuar, vendorë dhe ndërkombëtarë;
- Në punën e Komisionit mund të angazhohen edhe këshilltarë, ekspertë, në pajtim me udhëzimet procedurale e financiare të Kryesisë së Kuvendit;
- Komisioni, në punën e tij, mund të shfrytëzojë edhe ndihmën e ekspertëve, institucionalë dhe asociacioneve ndërkombëtare.

#### **Kryetari:**

- Drejton dhe koordinon punën e përgjithshme të Komisionit;
- Përfaqëson Komisionin;
- Raporton para Kuvendit për punën e Komisionit dhe paraqet qëndrimet e Komisionit;
- Për çështjet e caktuara mund ta autorizojë nënkryetarët raportues, që të paraqesin qëndrimet e Komisionit.

#### **Nënkryetarët:**

- Ndhimjnë kryetarin e Komisionit dhe e zëvendësojnë atë, kur ai mungon;
- Në marrëveshje me kryetarin e Komisionit, mbikëqyrin punën e grupeve punuese ose anëtarëve raportues për çështje ose fusha të caktuara, sipas vendimit të Komisionit;
- Në marrëveshje me kryetarin e Komisionit, paraqesin qëndrimet e Komisionit para Kuvendit.

#### **Raportuesit:**

- Anëtarët e Komisionit mund të angazhohen për të raportuar për çështje të caktuara apo për të mbuluar dhe hulumtuar një fushë të caktuar të Komisionit;
- Me pëlqim të Komisionit dhe kryetarit të tij, raportuesi mund t'i paraqesë qëndrimet e Komisionit edhe para Kuvendit.

## Agjenda e Komisionit, në mënyrë tabelore sipas muajve

Periudha	Agjenda e Komisionit	Detyrat e Komisionit
<b>Maj</b>	Miratimi i Fushëveprimit të Komisionit	Komisioni harmonizon fushëveprimin bazuar në vendimin e Kuvendit për formimin e Komisioneve parlamentare.
<b>Maj</b>	Hartimi i Planit të punës i Komisionit për vitin 2021	Njësia mbështetëse harton draftin e Planit të punës. Komisioni e miraton dhe e njofton Kuvendin.
<b>Maj</b>	Shqyrtimi i Raporteve vjetore të institucioneve të pavarura: - AKK dhe AKP;	Stafi mbështetës harton analizë të raporteve. Komisioni shqyrton dhe Rekomandon.
<b>Maj</b>	Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë për zgjedhjen e kandidatëve për kryetar dhe anëtarë të bordit të ARKEP-it	Stafi mbështetës njofton për plotësimin e kushteve të kandidateve. Komisioni shqyrton dhe Rekomandon.
<b>Qershor</b>	Procesi i rekrutimit për Drejtor të ARRU-së dhe Kryesuesit të Komisionit shqyrtues të Ankesave në ARRU	Komisioni kryen aktivitetet e rekrutimit dhe i rekomandon Kuvendit kandidatët. Stafi i Komisionit mbështet procesin në anën teknike.
<b>Qershor</b>	Raportim i Ministreve të linjës për programin dhe projektet e ministrisë për vitin 2021	Komisioni fton ministrin në raportim.
<b>Qershor</b>	Shqyrtimi i Raporteve vjetore të institucioneve të pavarura: - KOSTT; ARRU; ZRRE; KPMM;	Stafi mbështetës harton analizë të raporteve. Komisioni shqyrton dhe Rekomandon.
<b>Qershor</b>	Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit për Ligjin për shoqëritë tregtare	Stafi mbështetës harton draft Planin e punës dhe mbështet grupin e punës.

		Grupi i punës realizon monitorimin ne afat prej dy muajsh.
<b>Qershor</b>	Vizitë mbikëqyrëse institucioneve të pavarura: - NP KOSTT; ZRRE;	Komisioni njihet nga afër me punën e institucioneve të pavarura.
<b>Qershor</b>	Vizitë bizneseve vendore: Sektori IT - ICK	Komisioni realizon takime direkte në terren me biznese për t'u njohur nga afër me zhvillimet, kërkesat dhe sfidat e bizneseve vendore
<b>Qershor</b>	Projektligji për Inspektive (06.06.2021)	Dep.Ligjor i Kuvendit harton analizë ligjore përmbajtësore dhe teknike për projektligjin. Komisioni/Amendamentim dhe Rekomandim.
<b>Qershor</b>	Shqyrtimi i propozim-vendimeve të Qeverisë për zgjedhjen e kandidatëve për kryetar dhe anëtarë të bordeve që bien në fushëveprim të Komisionit (AKP, AKK, ZRRE dhe KPMM)	Stafi mbështetës njofton për plotësimin e kushteve të kandidateve. Komisioni shqyrton dhe Rekomandon.
<b>Qershor</b>	Nisma legjislative për projektligjin Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L - 042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.06/L-088	Komisioni merr nismë legjislative
<b>Korrik</b>	Vizitë mbikëqyrëse institucioneve të pavarura: - AKP	Komisioni njihet nga afër me punën e institucioneve të pavarura.
<b>Korrik</b>	Nisma legjislative për projektligjin për kriptovaluta	Komisioni merr nisme legjislative, Kërkohet hulumtim legjislativ nga administrata e Kuvendit
<b>Korrik</b>	Projektligji për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Lidhje me Transaksionet Elektronike (30.06.2021);  Projektligji për Masat për Uljen e Kostos së Shtirjes së Rrjeteve të Komunikimeve Elektronike të Shpejtësisë së Lartë (30.06.2021);  Projektligji për Turizëm (15.07.2021);  Projektligji për Mbrojtjen e Konkurrencës (15.07.2021);  Projektligji për Punimet nga Metalet e Çmuara (30.07.2021);  Projektligji për Tregti të Jashtme (30.07.2021);	Dep.Ligjor i Kuvendit harton analizë ligjore përmbajtësore dhe teknike për projektligjet.  Komisioni/Amendamentim dhe Rekomandim



	Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-079 për Investime Strategjike në Republikën e Kosovës (30.08.2021);	
<b>Korrik</b>	Shqyrtimi i Raporteve vjetore të institucioneve të pavarura: - ARKEP;	Stafi mbështetës harton analizë të raportit. Komisioni shqyrton dhe Rekomandon.
<b>Korrik</b>	Vizitë Ndërmarrjeve Publike Qendrore - Trepça dhe NP KEK	Komisioni njihet nga afër me punën e ndërmarrjeve publike.
<b>Korrik</b>	Procesi i rekrutimit të një anëtari të bordit të NP KOSTT nga radhët e komuniteteve	Komisioni kryen aktivitetet e rekrutimit dhe i rekomandon Kuvendit kandidatët. Stafi i Komisionit mbështet procesin në anën teknike.
<b>Korrik</b>	Nisma legislative për projektligjin për mbështetje të grave në biznes	Komisioni merr nismë legislative Kërkohet hulumtim legjislativ nga administrata e Kuvendit
<b>Gusht</b>	///	Muaji gusht është pushim i punës së Kuvendit në mes dy sesioneve.
<b>Shtator</b>	Procesi i rekrutimit për zv. Drejtor të ARRU-së	Komisioni kryen aktivitetet e rekrutimit dhe i rekomandon Kuvendit kandidatët. Stafi i Komisionit mbështet procesin në anën teknike.
<b>Shtator</b>	Mbikëqyrja e zbatimit të marrëveshjeve në mes të Kosovë dhe Serbisë - në kuadër të fushëveprimit të Komisionit.	KDI ofron analizë për nivelin e zbatimit të marrëveshjeve në mes të Kosovë dhe Serbisë, në kuadër fushëveprimit të Komisionit, si energjia, telekomunikacioni etj. Komisioni realizon takime me akteret relevant.
<b>Shtator</b>	Projektligji për Zonat Ekonomike (30.08.2021); Projektligji për Patenta (30.08.2021);	Dep.Ligjor i Kuvendit harton analizë ligjore përmbajtësore dhe teknike për projektligjet. Komisioni/Amendamentim dhe Rekomandim.
<b>Shtator</b>	Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit për Trepçën	Stafi mbështetës harton draft Planin e punës dhe mbështet grupin e punës.

		Grupi i punës realizon monitorimin ne afat prej dy muajsh.
<b>Shtator</b>	Shqyrtimi i Raportit vjetore të performancës së ndërmarrje publike	Stafi mbështetës harton analizë të raporteve. Komisioni shqyrton dhe Rekomandon.
<b>Shtator</b>	Raportim i ministrive të linjës për zbatimin e MSA-së dhe proceseve tjera integruese	Komisioni fton ministrin në raportim.
<b>Shtator</b>	Vizitë mbikëqyrëse institucioneve të pavarura: - ARKEP	Komisioni njihet nga afër me punën e institucioneve të pavarura.
<b>Shtator</b>	Tryeza për diskutimin e Planit Kombëtarë për Energji dhe Klimë	Përgatitje më aktorët relevant lidhur më hartimin e Planit Kombëtarë për Energji dhe Klimë
<b>Tetor</b>	Projektligji për Marka Tregtare (30.09.2021); Projektligji për Dizajn Industrial (30.09.2021); Projektligji për Përcaktimin e të Drejtave dhe Mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara (15.10.2021); Projektligji për Sekretin Tregtar (15.10.2021);	Dep.Ligjor i Kuvendit harton analizë ligjore përmbajtësore dhe teknike për projektligjet.  Komisioni/Amendamentim dhe Rekomandim.
<b>Tetor</b>	Nisma legislative për projektligjin për shuarjen e AKP-së	Komisioni merr nismë legislative
<b>Tetor</b>	Nisma legislative për projektligjin për tregtinë online	Komisioni merr nisme legislative Kërkohet hulumtim legjislativ nga administrata e Kuvendit
<b>Tetor</b>	Vizitë bizneseve: Investitorëve të huaj ne sektorin e energjisë	Takime direkte me biznesin e huaj për t'u njohur nga afër me zhvillimet, kërkesat dhe sfidat.
<b>Nëntor</b>	Nisma legislative për projektligjin për projektligjin për miniera dhe minerale	Komisioni merr nismë legislative
<b>Nëntor</b>	Projektligji për Tregtinë me Naftë dhe Produkte të Naftës në Kosovë (25.10.2021); Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Protokollin Shtesë 5 të Marrëveshjes për Amendimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (29.10.2021); Projektligji për Tregti të Brendshme (15.11.2021);	Dep.Ligjor i Kuvendit harton analizë ligjore përmbajtësore dhe teknike për projektligjet.  Komisioni/Amendamentim dhe Rekomandim.

<b>Nëntor</b>	Vizitë mbikëqyrëse institucioneve të pavarura: - AKK	Komisioni njihet nga afër me punën e institucioneve të pavarura.
<b>Nëntor</b>	Vizitë Ndërmarrjeve Publike Qendrore - NP Telekomit i Kosovës	Komisioni njihet nga afër me punën e ndërmarrjeve publike.
<b>Nëntor</b>	Mbledhje e përbashkët me komisionin homolog ose komisionet homologe të Kuvendit të Shqipërisë, për monitorimin e marrëveshjeve në mes dy vendeve.	Komisionet respektive mbajnë mbledhje të përbashkët në Prishtinë ose Tiranë, për të analizuar zbatimin e marrëveshjeve në mes dy vendeve. Protokollin dhe stafin mbështetës i komisioneve respektive organizojnë mbledhjen.
<b>Nëntor</b>	Shqyrtimin e projektbuxhetit të ministrave të linjës dhe Institucioneve të pavarura lidhur me kërkesat buxhetore për vitin 2022.	Komisioni fton ministrin dhe kryesuesit e institucioneve të pavarura në takim për të dëgjuar kërkesat dhe pikëpamjet e tyre për buxhetin.
<b>Dhjetor</b>	Projektligji për Rezervat e Obligueshme të Naftës (30.11.2021); Projektligji për Inovacion dhe Ndërmarrësi (30.11.2021); Projektligjit për Ndërmarrje Publike (30.11.2021); Projektligji për Masat e Sigurisë së Rrjeteve dhe Sistemeve të Informacionit (30.11.2021)	Dep.Ligjor i Kuvendit harton analizë ligjore përmbajtësore dhe teknike për projektligjet. Komisioni/Amendamentim dhe Rekomandim.
<b>Dhjetor</b>	Raportimi i ministrave të ministrave të linjës për realizimin e programit dhe projekteve të vitit 2021 dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi.	Komisioni fton ministrin në raportim.
<b>Dhjetor</b>	Raporti vjetor i punës së Komisionit	Njësia mbështetëse harton draftin e raportit të punës. Komisioni miraton raportin vjetor të punës së vet.

Miraturar më 28.05.202

Prishtinë  
Përgatitur nga:  
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Ferat SHALA